

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT
VITI 2026**

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Natyra e kërimit	Objekti i kërkesës (përmbledhje e objektit të kërkesës, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)	Përgjigje (përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)	Data e kthimit të përgjigjes	Mënyra e përfundimit të kërkesës (përgjigjja jepet e plotë / e kufizuar / e deleguar)	Tarifa
74.	04.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Në mbështetje të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), subjekti kërkon informacion për sa më poshtë vijon:</p> <p>1. Në rang kombëtar, sa është numri i saktë i Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU) të angazhuar në procesin e prodhimit, përpunimit, ambalazhimit, etiketimit dhe tregtimit të produktit ‘mjaltë’?</p> <p>1.1. Nga këta OBU, sa është numri i atyre të pajisur me licensën përkatëse dhe sa janë të papajisur me licensë?</p> <p>1.2. Në cilët qarqe janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre këto OBU?</p>	<p>1. Nga verifikimet e kryera, rezulton se për vitin 2026 janë në total 16 (gjashtëmbëdhjetë) OBU, të cilët ushtrojnë aktivitetin tregtar specifik në fushën e “<i>Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e mjaltit</i>”.</p> <p>1.1. Nga këto OBU, 11 (njëmbëdhjetë) prej tyre janë të pajisur me licensën përkatëse ndërsa 5 (pesë) të tjerë nuk janë të pajisur me licensë.</p> <p>1.2. OBU-të e lartpërmendur janë të regjistruar dhe e ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar në qarqet: Tiranë, Durrës, Lezhë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Korçë.</p> <p>2. Nga përpunimi i të dhënave të administruara nga trupat inspektuese në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK), rezulton se produkti ‘mjaltë’ është importuar në Republikën e Shqipërisë përgjatë 5 (pesë) vjeçarit të fundit, sipas sasisë që pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.</p>	18.05.2026	e plotë	nuk ka

2. Sa është sasia e produktit ‘mjaltë’, e importuar në Republikën e Shqipërisë, për 5 (pesë) vjeçarin e fundit?

2.1. Sa është sasia e produktit ‘mjaltë’, e eksportuar nga Republika e Shqipërisë, për 2 (dy) vjeçarin e fundit, e ndarë sipas çdo muaji?

**SASIA E PRODUKTIT ‘MJALTË’,
IMPORTUAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Viti	Totali
2021	17.445
2022	15.686
2023	51.448
2024	55.559
2025	43.245

**Njësia matëse: Ton*

2.1. Nga përpunimi i të dhënave të administruara, rezulton se produkti ‘mjaltë’ është eksportuar nga Republika e Shqipërisë, përgjatë 2 (dy) vjeçarit të fundit, sipas sasisë që pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

**SASIA E PRODUKTIT ‘MJALTË’,
EKSPORTUAR NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË**

Viti	Totali
2025	12,2805
2026 (periudha Janar-Prill)	1,86948

**Njësia matëse: Ton*

75.	04.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Gjatë vitit 2026, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka analizuar mostra të produktit ‘turshi’, jashtë Republikës së Shqipërisë.</p> <p>1. Në cilin shtet janë dërguar mostrat për analizim?</p> <p>2. Sa mostra të produktit ‘turshi’ janë analizuar?</p> <p>3. Sa prej tyre kanë dalë me probleme?</p> <p>4. Cila është natyra e problemeve të konstatuara në këto mostra?</p> <p>5. A bëhet fjalë për praninë e pesticideve të ndaluara, pesticideve të lejuara mbi normë, apo për përmbajtje të metaleve të rënda?</p> <p>6. Ju lutem specifikoni mostrat që kanë rezultuar me mospërputhje nga analizat (duke përfshirë lotet, produktet dhe origjinën), si dhe ato që kanë rezultuar në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore.</p> <p>7. Sa është sasia e produkteve të bllokuara dhe sa është sasia e hequr nga tregu si rezultat i këtyre analizave?</p>	<p>Në përgjigje të pyetjeve 1, 2 dhe 3, informojmë se mostrat e produktit ‘Turshi’, janë dërguar për analizim në laborator të akredituar në Itali. Kështu, në total janë dërguar 38 (tridhjetë e tetë) mostra, nga të cilat, janë kthyer përgjigje për 37 (<i>tridhjetë e shtatë</i>) mostra të analizuara, ndërsa 1 (<i>një</i>) mostër është ende në pritje të rezultatit të analizës. Nga përgjigjet e mostrave të analizuara, 4 (katër) prej tyre kanë rezultuar jokonforme.</p> <p>Në përgjigje të pyetjeve 4 dhe 5, informojmë se referuar Udhëzimit nr.17, datë 25.04.2025 “<i>Mbi nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në ushqimet dhe ushqimet për kafshë me origjinë bimore dhe shtazore</i>” (legjislacionit për pesticidet e ndaluara) dhe Udhëzimit nr.4, datë 09.02.2024 “<i>Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në ushqime</i>”, rezulton se 2 (<i>dy</i>) mostra kanë rezultuar mbi normë për sa i përket përmbajtjes së metaleve të rënda dhe 2 (<i>dy</i>) mostra të tjera për mbetje pesticide të ndaluar të dedektuar.</p> <p>Në përgjigje të pyetjes 6, në lidhje me mostrat të cilat kanë rezultuar <u>jokonforme</u>, specifikojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Produkti “<i>Kastravec turshi</i>” me nr.12-Prot.1039 dhe vendi i origjinës: Turqi; • Produkti “<i>Kastravec turshi</i>” me nr.13-Prot.1039 dhe vendi i origjinës: Turqi; • Produkti “<i>Sallatë e përzier e marinuar</i>” me nr.09-Prot.1036 dhe vendi i origjinës: Maqedoni e Veriut; dhe • Produkti “<i>Perime turshi</i>” me nr.220 Prot.-n°123 dhe vendi i origjinës: Elbasan. 	18.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	--	--	------------	---------	--------

			<p>8. Çfarë masash administrative janë marrë ndaj subjekteve përgjegjëse?</p> <p>9. Duke qenë se raportimi është detyrim ligjor si për rastet e importit, ashtu edhe për ato kur kompanitë eksportojnë produkte jashtë vendit, a janë raportuar në sistemin ‘RASFF’ mostrat që rezultuan me probleme?</p>	<p>Në lidhje me mostrat të cilat kanë rezultuar <u>konforme</u> (në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore), specifikojmë se nga 33 (tridhjetë e tre) mostra në total, 24 (njëzet e katër) prej tyre janë marrë <u>në subjekte prodhuese vendase në terren</u> ndërsa 9 (nëntë) prej tyre janë marrë <u>në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK)</u>, konkretisht:</p> <p>Mostra të marra në terren:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Produkti “Trangull marinadë ekstra” me nr.lot-i 26 DH25, pranë një subjekti tregtar në Berat; • Produkti “Speca marinadë” me nr.2607099 Prot.167/5, pranë një subjekti tregtar në Berat; • Produkti “Sallatë marinadë” me nr.2607100 Prot.179/5, pranë një subjekti tregtar në Berat; • Produkti “Sallatë e përzier” me nr.2607101 Prot.181/5, pranë një subjekti tregtar në Berat; • Produkti “Domate jeshile” me nr.2607061 Prot.163/5, pranë një subjekti tregtar në Fier; • Produkti “FEFERONI” me nr.2607054 Prot.163/6, pranë një subjekti tregtar në Fier; • Produkti “Spec djegës” me nr.2607056 Prot.164/6, pranë një subjekti tregtar në Fier; • Produkti “Trangull marinadë” me nr.2607058 Prot.164/5, pranë një subjekti tregtar në Fier; • Produkti “Speca marinadë” me nr.2607063 Prot.165/6, pranë një subjekti tregtar në Fier; • Produkti “Trangull marinadë” me nr.2607055 Prot.165/5, pranë një subjekti tregtar në Fier; • Produkti “Ullinj në tretësirë” me nr.2607045 Prot.160/7, pranë një subjekti tregtar në Fier; • Produkti “Ullinj të përpunuar” me nr.2607049 Prot.161/7, pranë një subjekti tregtar në Fier; 			
--	--	--	---	--	--	--	--

- Produkti “*Domate turshi*” me nr.2606747 Prot.1037, pranë një subjekti tregtar në Tiranë;
- Produkti “*Tranguj turshi*” me nr.2606744 Prot.1040, pranë një subjekti tregtar në Tiranë;
- Produkti “*Ullinj në vakum*” me nr.2606751 Prot.1042, pranë një subjekti tregtar në Tiranë;
- Produkti “*Kastravec Turshi*” me nr.2607051 Prot.156/5, pranë një subjekti tregtar në Fier;
- Produkti “*FEFERONP*” me nr.2607052 Prot.156/6, pranë një subjekti tregtar në Fier;
- Produkti “*Turshi*” me nr.2606754 Prot.1043/1, pranë një subjekti tregtar në Tiranë;
- Produkti “*Turshi*” me nr.2606752 Prot.1043, pranë një subjekti tregtar në Tiranë;
- Produkti “*Kastravec Turshi*” me nr.2606737 Prot.1038, pranë një subjekti tregtar në Tiranë;
- Produkti “*Turshi Mix*” me nr.2606738 Prot.1038, pranë një subjekti tregtar në Tiranë;
- Produkti “*Tranguj të vegjël me mjaltë*” me nr.2606736 Prot.1036, pranë një subjekti tregtar në Tiranë;
- Produkti “*Tranguj marinadë*” me nr.2606735 Prot.1036, pranë një subjekti tregtar në Tiranë;
- Produkti “*Tranguj marinadë*” me nr.2606745 Prot.1041, pranë një subjekti tregtar në Tiranë.

Mostra të marra në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK):

- Produkti “*Turshi*” me nr.lot-i LR107, pranë PIK Durrës;
- Produkti “*Kastravec Turshi*” me nr.lot-i LR346, pranë PIK Durrës;
- Produkti “*Karcuif i konservuar*” me nr.2608325 Prot.78, pranë PIK Vlorë;

			<ul style="list-style-type: none">• Produkti “<i>Turshi</i>” me nr.lot-i L31425AG, pranë PIK Durrës;• Produkti “<i>Kastravec Turshi</i>” me nr.lot-i LK042, pranë PIK Durrës;• Produkti “<i>Turshi kastravec</i>” me nr.2607832 Prot.45/1, pranë PIK Kukës;• Produkti “<i>Turshi speci</i>” me nr.2607834 Prot.45/2, pranë PIK Kukës;• Produkti “<i>Speca turshi</i>” me nr.2611253 Prot.78, pranë PIK Kukës;• Produkti “<i>Speca turshi</i>” me nr.2611249 Prot.95, pranë PIK Kukës. <p>Shënim: Sikurse më lart sqaruar, 1 (një) mostër ende në pritje të rezultatit ë analizave.</p> <p>Në përgjigje të pyetjes 7, nga verifikimet e kryera, rezulton se sasia e produkteve të bllokuara është në total 5211.96 kg.</p> <p>Në përgjigje të pyetjes 8, masat administrative të marra ndaj subjekteve tregtare ku janë marrë dhe kanë rezultuar mostrat jokonforme, konsistojnë në “<i>Gjobë</i>” dhe “<i>Paralajmërim</i>”, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Në përgjigje të pyetjes së fundit, sqarojmë se sistemi ‘RASFF’ është një rrjet i BE, i cili përdoret me qëllim për të garantuar sigurinë ushqimore dhe të ushqimit për kafshë. Ky sistem lejon vendet anëtare të ndajnë informacionin e tyre në kohë reale për produktet të cilat paraqesin rrezik për shëndetin, në të cilin, Shqipëria nuk është vend anëtar.</p>		
--	--	--	---	--	--

76.	04.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Subjekti i interesuar planifikon hapjen e një restoranti në Shqipëri dhe kërkon informacion lidhur me kërkesat (kriteret) dhe licencën e nevojshme për hapjen e një ‘take-away food’ ose të një restoranti.</p> <p><i>Shënim: Kërkesa për informacion është dërguar në anglisht.</i></p>	<p>Në përgjigje të kërkesës për informacion, një subjekt i cili ka përfunduar regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në fushën e ushqimit në aktivitetin “<i>Restorant ose take-away food</i>”, është i detyruar të njoftojë drejtorinë rajonale përkatëse të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (sipas rrethit), për vendin e ushtrimit të aktivitetit tregtar dhe natyrën e tij, jo më vonë se 30 (<i>tridhjetë</i>) ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë.</p> <p>Subjektet që kryejnë aktivitet me pakicë nuk licensohen, pra nuk janë të detyruar të pajisen me licensë në QKB. Nëse subjekti kryen aktivitet me shumicë, ai është i detyruar që të kryejë aplikimin për pajisje me licensë pranë QKB, aplikim i cili realizohet <i>online</i>. Lista e dokumentacionit të nevojshëm që duhet të paraqitet, gjendet e publikuar në faqen zyrtare të QKB.</p> <p>Është detyrë e çdo Operatori të Biznesit Ushqimor (OBU) që përgatit, përpunon, prodhon, ruan dhe shpërndan produkte ushqimore në mjedisë të ushtrimit të aktivitetit me pakicë apo shumicë, të sigurojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave dhe kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës, rregullat dhe standardet e detyrueshme tekniko-teknologjike, në ambientet e tij, si dhe dokumentacionin e rregullt të produkteve ushqimore sipas legjislacionit në fuqi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – ligji nr.9863, datë 28.01.2008 “<i>Për Ushqimin</i>” (<i>i ndryshuar</i>); – ligji nr.99/2024 “<i>Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë</i>”; 	11.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	--	------------	---------	--------

			<ul style="list-style-type: none"> – VKM nr.434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”; – Udhëzimi nr.22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimorë”. <p>Kushtet që subjekti duhet të plotësojë për aktivitetin e tij prodhues dhe/ose tregtues të ushqimeve, janë sa më poshtë renditur:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Vendndodhja, kushtet dhe gjendja e stabilimentit, planimetria e prodhimit, zyrat, mjedisi, mjetet e transportit (nëse kryen transport); – Kushtet higjiëno-sanitare të prodhimit/përpunimit, tregtimit, etj. – Librezat shëndetësore (të detyrueshme për çdo person cili është pjesë e personelit që punon në fushën e trajtimit apo shitjes së ushqimit); – Lëndët e para, shtesat teknologjike (dokumentacioni shoqërues) sipas legjislacionit në fuqi; – Fletë Analiza e ujit për ngarkesën mikrobiologjike; – Mënyra e paketimit dhe materialet paketuese; – Etiketimi së bashku me dokumentet shoqëruese të lëndëve të para dhe produktit përfundimtar; – Proceset teknologjike që zbatohen në prodhim (karta teknologjike); – Drejtuesi teknik (aktivitet prodhues) ose personi përgjegjës për sigurinë ushqimore (shitje / shpërndarje); 			
--	--	--	---	--	--	--

			<p>– Plani i Vetëkontrollit ‘HACCP’, sipas parashikimeve të nenit 26 të ligjit nr. bazuar në nenit 26 të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “<i>Për Ushqimin</i>” (i ndryshuar);</p> <p>– Sistemi i gjurmueshmërisë;</p> <p>– Plani 3D.</p> <p>Në rastin konkret, nëse subjekti i interesuar do të kryejë veprimtari tregtare në fushën e “<i>prodhim/përpunim dhe shpërndarje ushqimesh</i>” dhe nëse ka detyrimin ligjor për pajisjen me licensë, si më lart shpjeguar, atëherë subjekti duhet të aplikojë për pajisje me licensë në veprimtarinë me Kod II.1.A.1: “<i>Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz</i>”, ku të përkrahë i plotë specialiteti/specialitetet (në rastin konkret: take-away food ose restorant).</p> <p>Hapat proceduriale dhe mënyrat e aplikimit për pajisje me licensë, janë si më poshtë vijon.</p> <p>– Aplikimi për regjistrim/pajisje me licensë në portalin ‘e-Albania’;</p> <p>– Përpara aplikimit, subjekti duhet të sigurohet që të plotësojë kriteret përkatëse të licensimit (sipas legjislacionit në fushën e ushqimit);</p> <p>– Aktet e kërkesë-aplikimit duhet të kenë përputhshmëri të adresës së ushtrimit të aktivitetit të kërkuar për licensim dhe adresës faktike;</p> <p>– Procedura e shqyrtimit të kërkesë-aplikimit për pajisje me licensë që nga momenti i shfaqjes në sistemin aplikativ të QKB-së në kompetencë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, zgjat 20</p>			
--	--	--	--	--	--	--

			<p>(tridhjetë) ditë (afati kohor) për veprimtaritë me kod II.I.A.1 dhe kryhet nga drejtoria rajonale përkatëse, e cila ushtron kontrollin në vend për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve përkatëse të licensimit, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Shënim: Kthim përgjigjja e kërkesës për informacion është dërguar në anglisht tek subjekti i interesuar.</i></p>																																												
77.	05.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Sa asgjësime ka kryer subjekti “Gj*****” për periudhën Janar – Prill 2026?</p> <p>Lutem të saktësohet data, muaji dhe viti kur janë kryer asgjësimet dhe cila ka qenë sasia përkatëse për secilën procedurë asgjësimi.</p>	<p>Nga verifikimet e kryera, rezulton se subjekti tregtar “Gj*****” ka kryer në total 19,573 ton asgjësime të produkteve.</p> <p>Specifikimet e këtyre asgjësimeve, sipas kërkesës së subjektit të interesuar (“<i>Lutemi të na saktësoni datën, muajin, vitin kur janë kryer procedurat e asgjësimit</i>”), pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Data</th> <th>Muaji</th> <th>Sasia / Ton produkte të asgjësuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020</td> <td>—</td> <td>—</td> <td>nuk ka</td> </tr> <tr> <td>2021</td> <td>—</td> <td>—</td> <td>nuk ka</td> </tr> <tr> <td>2022</td> <td>20</td> <td>01</td> <td>17,156 ton produkte</td> </tr> <tr> <td>2022</td> <td>03</td> <td>02</td> <td>2,364 ton produkte</td> </tr> <tr> <td>2023</td> <td>—</td> <td>—</td> <td>nuk ka</td> </tr> <tr> <td>2024</td> <td>07</td> <td>05</td> <td>0,053 ton produkte</td> </tr> <tr> <td>2025</td> <td>—</td> <td>—</td> <td>nuk ka</td> </tr> <tr> <td>2026</td> <td>—</td> <td>—</td> <td>nuk ka</td> </tr> <tr> <td colspan="3">TOTAL</td> <td>19, 573 ton produkte</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Data	Muaji	Sasia / Ton produkte të asgjësuar	2020	—	—	nuk ka	2021	—	—	nuk ka	2022	20	01	17,156 ton produkte	2022	03	02	2,364 ton produkte	2023	—	—	nuk ka	2024	07	05	0,053 ton produkte	2025	—	—	nuk ka	2026	—	—	nuk ka	TOTAL			19, 573 ton produkte	18.05.2026	e plotë	nuk ka
Viti	Data	Muaji	Sasia / Ton produkte të asgjësuar																																												
2020	—	—	nuk ka																																												
2021	—	—	nuk ka																																												
2022	20	01	17,156 ton produkte																																												
2022	03	02	2,364 ton produkte																																												
2023	—	—	nuk ka																																												
2024	07	05	0,053 ton produkte																																												
2025	—	—	nuk ka																																												
2026	—	—	nuk ka																																												
TOTAL			19, 573 ton produkte																																												

78.	07.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Sa asgjësime ka kryer subjekti “R*****-L***” për periudhën Janar – Prill 2026?</p> <p>Lutem të saktësohet data, muaji dhe viti kur janë kryer asgjësimet dhe cila ka qenë sasia përkatëse për secilën procedurë asgjësimi.</p>	<p>Nga verifikimet e kryera, rezulton se subjekti tregtar “R*****-L***” ka kryer në total 14 (katërbëdhjetë) procedura asgjësimi për periudhën Janar 2020 – Maj 2026.</p> <p>Specifikimet e këtyre asgjësimeve, sipas kërkesës Tuaj (“Lutemi të na saktësoni datën, muajin, vitin kur janë kryer procedurat e asgjësimit”), pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="1010 478 1630 1284"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Data</th> <th>Muaji</th> <th>Sasia / Ton produkte të asgjësuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>2020</td><td>22</td><td>04</td><td>5.022</td></tr> <tr><td>2020</td><td>25</td><td>09</td><td>5.089</td></tr> <tr><td>2021</td><td>29</td><td>03</td><td>5.7</td></tr> <tr><td>2021</td><td>14</td><td>09</td><td>0.10395</td></tr> <tr><td>2021</td><td>10</td><td>11</td><td>7.477</td></tr> <tr><td>2022</td><td>28</td><td>04</td><td>0.2176</td></tr> <tr><td>2022</td><td>17</td><td>06</td><td>5.705</td></tr> <tr><td>2023</td><td>20</td><td>04</td><td>10.296</td></tr> <tr><td>2023</td><td>16</td><td>10</td><td>7.629</td></tr> <tr><td>2024</td><td>03</td><td>05</td><td>9.717</td></tr> <tr><td>2024</td><td>28</td><td>10</td><td>8.819</td></tr> <tr><td>2025</td><td>02</td><td>05</td><td>10.995</td></tr> <tr><td>2025</td><td>13</td><td>10</td><td>11.41057</td></tr> <tr><td>2026</td><td>04</td><td>05</td><td>14.938</td></tr> <tr> <td colspan="3">TOTAL</td> <td>103.11912 ton produkte</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Data	Muaji	Sasia / Ton produkte të asgjësuar	2020	22	04	5.022	2020	25	09	5.089	2021	29	03	5.7	2021	14	09	0.10395	2021	10	11	7.477	2022	28	04	0.2176	2022	17	06	5.705	2023	20	04	10.296	2023	16	10	7.629	2024	03	05	9.717	2024	28	10	8.819	2025	02	05	10.995	2025	13	10	11.41057	2026	04	05	14.938	TOTAL			103.11912 ton produkte	20.05.2026	e plotë	nuk ka
Viti	Data	Muaji	Sasia / Ton produkte të asgjësuar																																																																				
2020	22	04	5.022																																																																				
2020	25	09	5.089																																																																				
2021	29	03	5.7																																																																				
2021	14	09	0.10395																																																																				
2021	10	11	7.477																																																																				
2022	28	04	0.2176																																																																				
2022	17	06	5.705																																																																				
2023	20	04	10.296																																																																				
2023	16	10	7.629																																																																				
2024	03	05	9.717																																																																				
2024	28	10	8.819																																																																				
2025	02	05	10.995																																																																				
2025	13	10	11.41057																																																																				
2026	04	05	14.938																																																																				
TOTAL			103.11912 ton produkte																																																																				

79.	07.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Lidhur me njoftimin e fundit të sistemit ‘RASFF’ mbi praninë e bakterit ‘Salmonella spp’ në suplementin ushqimor “M***** O*****” me origjinë nga Gjermania, i cili është shpërndarë edhe në tregun shqiptar përmes operatorit importues “E*** P**”:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa është sasia totale e produktit të importuar? 2. Sa është sasia e shitur? 3. Sa është sasia e bllokuar? 4. Në cilat qytete është shpërndarë? 5. A ka arritur Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të sigurojë gjurmueshmëri të plotë dhe të pandërprerë të produktit “M***** O*****”, nga importi deri në pikat fundore të shitjes në Shqipëri? 6. Sasia e bllokuar e produktit, do të asgjësohet në Shqipëri apo do të kthehet në vendin e origjinës? 7. A ka marrë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, masa administrative ndaj subjektit? Nëse po, cilat janë konkretisht masat e marra? 	<p><i>Në përgjigje të pyetjeve 1, 2 dhe 3</i>, nga verifikimet e kryera, rezulton se sasia totale e importuar para njoftimit të ardhur nga sistemi ‘RASFF’ mbi produktin “M***** O*****” është 12 njësi x 125 kg (në total 1.5 kg). Sasia e shitur e këtij produkti është 6 njësi x 125 kg (në total 0.75 kg) ndërsa sasia e bllokuar është 6 njësi x 125 kg (në total 0.75 kg). <i>Në përgjigje të pyetjeve 4 dhe 5</i>, nga verifikimet e kryera, rezulton se produkti është shpërndarë në Tiranë dhe Elbasan. Kështu, duke u bazuar në sistemin e gjurmueshmërisë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit disponon dokumentacion të plotë duke filluar nga praktika e importit, deri në pikat fundore të shitjes. <i>Në përgjigje të pyetjes 6</i>, në lidhje me sasinë 6 njësi gjendje në subjekt, nga trupa inspektuese e Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë, u krye bllokimi i kësaj sasive me destinacion asgjësimin – konform nenit 46, pika 1 e ligjit nr.99/2024 “<i>Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë</i>” dhe legjislacionit në fuqi. <i>Në përgjigje të pyetjes 7</i>, në mbështetje të pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 44 të ligjit nr.99/2024 “<i>Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë</i>”, subjekti u <u>paralajmërua</u> për mbajtjen të bllokuar të produktit të pasigurt, deri në kryerjen e procedurës së asgjësimit, si dhe iu la për detyrë <u>njoftimi</u> i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë, në lidhje me kryerjen e kësaj procedure të asgjësimit. <i>Së fundmi, sqarohet se pranë subjekteve tregtare ku ishte shitur produkti, u procedua me afishimin e njoftimit për konsumatorët.</i></p>	20.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	---	------------	---------	--------

80.	08.05.2026	Denoncim	<p>Subjekti i interesuar është banues në Tiranë dhe referon një problematikë lidhur me aromat e pakëndshme që vijnë nga një subjekt tregtar (i cili tregton byrekë dhe produkte gatimi).</p> <p>Nisur nga shqetësimet e vazhdueshme për aromat e rënda të gatimeve, edhe për shkak të mungesës së një sistemi të rregullt aspirimi, kërkohet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, kryerja e një kontrolli dhe verifikimi mbi kushtet e sigurisë dhe higjienës në këtë subjekt, veçanërisht të instalimeve të gazit dhe sistemit të aspirimit.</p>	<p>Referuar denoncimit të ardhur, nga ana e trupës inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, u kryen verifikimet përkatëse në terren lidhur me rastin në fjalë. Konkretisht, trupa inspektuese u paraqit pranë subjektit, ku u konstatua se ky i fundit ushtronte aktivitetin në fushën e prodhimeve të brumit (byrektore) në kushte të përgjithshme higjieno-sanitare të përshtatshme për natyrën e aktivitetit. Po kështu, pajisjet dhe mjetet e punës rezultuan të përshtatshme dhe funksionale; produktet ruheshin në kushte të përshtatshme sipas natyrës së tyre dhe ndodheshin brenda afateve të përdorimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Punonjësit e subjektit tregtar ishin të pajisur me uniformat e punës dhe librezat shëndetësore.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit, OBU dispononte certifikatën e shërbimit D.D.D. për ambientin, si dhe analizën bakteriologjike të ujit të rrjetit. Gjurmueshmëria funksiononte në bazë të faturave tatimore dhe sistemi i aspirimit në ambientet e brendshme të subjektit rezultoi funksional. Referuar nenit 44, pikat 2, 3, 5 dhe 6 të ligjit nr.99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ndaj subjektit u mor masa administrative “Paralajmërim” për largimin e sendeve të tepërta që ndodhen në ambientet e subjektit.</p> <p>Për sa më sipër, vlerësimi dhe kontrolli mbi problematika të tilla si: aromat e pakëndshme, zhurmat, ndotja e ajrit, shkarkimet, etj., nuk bëjnë pjesë në kompetencat ligjore të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.</p>	20.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	----------	--	---	------------	---------	--------

81.	08.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Në lidhje me rastin e helmimit të dyshuar nga ushqimi, i studentëve të Akademisë së Sigurisë në Sauk, kërkohet informacion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat produkte ushqimore janë marrë konkretisht si mostra për analizë laboratorike? 2. Lutem të na vini në dispozicion listën e plotë të mostrave të sekuestruara. 3. Pse janë marrë mostra vezësh, djathi, kosi dhe sallami, nëse këto produkte nuk kanë qenë pjesë e menisë së konsumuar nga kursantët në ditën e incidentit. 4. A janë marrë mostra nga ushqimet e servitura konkretisht atë ditë, përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> • makarona; • pilaf; • gjellë me patate; • tavë me presh dhe mish. 5. Nëse jo, cili është shkaku procedural për mosmarrjen e tyre? 6. A ekzistonin mostrat rezervë të ushqimit, të cilat sipas rregullave sanitare ruhen për 24 orë? <ul style="list-style-type: none"> • Nëse po, ku ndodheshin? • Kush kishte përgjegjësinë për ruajtjen e tyre? 	<p>Në lidhje me rastin konkret, mostrat e marra për analizë laboratorike, janë marrë si nga ushqimet e servitura, ashtu edhe nga produkte të tjera ushqimore të konstatuara në momentin e ushtrimit të kontrollit në subjekt, me qëllim verifikimin e plotë të kushteve higjieno-sanitare dhe evidentimin e burimit të mundshëm të kontaminimit. Kështu, janë kryer kampionime për produktet: makarona, pilaf, fasule, sallam, kos, djathë i bardhë lope, sallam dhe vezë.</p> <p>Lidhur me pyetjen e parashtruar mbi mostrat e sekuestruara, sqarojmë se nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, janë kryer kampionime të produkteve të gatshme dhe produkteve të konstatuara në momentin e kontrollit në këto subjekte, më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • në adresën Akademia e Sigurisë në Sauk, ku janë kampionuar produktet: makarona, pilaf, fasule, sallam dhe kos — produkte të gatshme për t'u konsumuar; • në adresën Garnizoni pranë Akademisë Sigurisë Tiranë, ku janë kampionuar produktet: djathë i bardhë lope, sallam, kos lope dhe vezë. <p><i>Në përgjigje të pyetjes së tretë</i>, në momentin e kontrollit nga verifikimi në adresën Garnizoni pranë Akademisë Sigurisë Tiranë, nuk janë konstatuar produkte të gatshme për t'u konsumuar. Në këto kushte, në kuadër të hetimit epidemiologjik dhe kontrollit të sigurisë ushqimore, nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit janë kryer mostrime të produkteve të konstatuara gjendje në momentin e kontrollit në këtë adresë, me qëllim verifikimin e plotë të</p>	21.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	---	------------	---------	--------

			<ul style="list-style-type: none"> • A janë sekuestruar dhe analizuar? • Nëse jo, kush mban përgjegjësi për asgjësimin apo mosadministrimin e tyre? <p>7. Në cilin laborator janë dërguar mostrat për analizë?</p> <p>8. Sa inspektime ka kryer Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj subjektit “****” gjatë periudhës Janar 2020- Prill 2026?</p> <p>8. Kërkohej informacion për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • datat dhe procesverbalet e inspektimeve; • shkeljet e konstatuara • masat administrative dhe gjrobat e vendosura. 	<p>kushteve higjieno-sanitare dhe përjashtimin e çdo burimi të mundshëm kontaminimi në subjekt.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjeve 4 dhe 5</i>, sqarojmë se nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, janë kryer mostrime të produkteve të gatshme të konstatuara gjendje në momentin e kontrollit në adresën Akademia e Sigurisë në Sauk, ku në të cilën, produktet vijnë të përgatitura nga adresa tjetër e këtij subjekti, si “makarona, pilaf, fasule, sallam dhe kos”. Ndërsa, në adresën Garnizoni pranë Akademisë Sigurisë Tiranë, në momentin e kontrollit, nuk janë konstatuar ushqime të gatshme për t’u konsumuar, por u konstatuan lëndë të para të cilat u morën mostra për analizim e më konkretisht: djathë i bardhë lope; kos lope; vezë; dhe sallam — për analizim të ngarkesave mikrobiale pranë Laboratorit të ISUV. Pra, nga ana e AKU, është kryer procedura e marrjes së mostrave për të gjitha produktet e gatshme dhe lëndët e para të konstatuara gjendje, në momentin e kryerjes së kontrollit për të evidentuar çdo burim kontaminimi.</p> <p>Nga verifikimet e kryera në të dy adresat e lartpërmendura, janë konstatuar kampione në ruajtje sipas dietave të servitura. Sqarojmë se për këto kampione në ruajtje, janë kryer mostrime nga institucionet e tjera kompetente, të cilat kanë kryer procedura inspektimi pranë subjektit, gjatë prezencës së trupës inspektuese të AKU. Nga ana jonë, janë kryer mostrime vetëm të produkteve të gatshme dhe lëndëve të para të konstatuara gjendje në momentin e kryerjes së kontrollit pranë subjekteve.</p>			
--	--	--	--	---	--	--	--

Në përgjigje të pyetjes 7, sikurse më lart përmendur, mostrat e kampionuara në të dy adresat, janë dërguar për analizim pranë Laboratorit ISUV.

Në përgjigje të pyetjes së fundit, nga verifikimet e kryera dhe përpunimi i informacionit të administruar nga Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë, rezulton se për periudhën Janar 2020 - Prill 2026, ndaj subjektit janë kryer në total **8 (tetë) inspektive**.

Këto inspektive janë kryer në datat e renditura më poshtë:

- 31.05.2021;
- 31.08.2023;
- 01.02.2024;
- 06.03.2024;
- 05.07.2024;
- 27.02.2025;
- 08.04.2025;
- 10.02.2026.

Në lidhje me shkeljet e konstatuara, në bazë të konstatimeve të evidentuara gjatë inspektimit, **subjektit iu la detyrë të analizojë produktet e gatshme (gjellët e gatuar për konsum)**.

Në lidhje me masat administrative dhe gjobat e vendosura, gjatë kësaj periudhe rezulton se pranë subjektit është vendosur **1 (një) masë administrative “Paralajmërim” për gjetjen e sipërcituar**.

82.	13.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Në vijim të ngjarjes së helmimit të 56 studentëve të Akademisë së Sigurisë, kërkoj informacion mbi veprimtarinë e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit gjatë këtyre ditëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <i>A e ka konfirmuar Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nëse bëhet fjalë për helmim ushqimor të studentëve të Akademisë së Sigurisë?</i> <p>Lidhur me pyetjen e parashtruar, sqarojmë se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka marrë masa referuar Raport-Provës për produktin <i>makarona të gatuaratë</i> rezultuar pozitive, si dhe bazuar në Raportin Epidemiologjik të ardhur nga ISHP në bashkëpunim me NJVKSH “<i>Mbi shpërthimin epidemik me shenja gastrointestinale në Akademinë e Policisë, Sauk, Tiranë</i>”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Çfarë mostrash ushqimore janë marrë për analiza pas ngjarjes dhe në cilin laborator po kryhen ekzaminimet?</i> <p>Nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është kryer kampionimi për produktet e gatshme për t’u ngrënë dhe lëndët e para, më konkretisht “<i>makarona të gatua, pilaf i gatuar, fasule të gatua, sallam i gatuar dhe kos</i>”, djathë i bardhë lope, vezë, dhe janë dërguar për analizim të treguesve mikrobiologjikë në Laboratorin e ISUV. Gjithashtu, në subjekt, në vijim të ndjekjes së rastit, si dhe referuar njoftimit të ardhur nga subjekti për realizimin e detyrave të lëna, nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit janë kryer marrje mostrash tamponi ambiental dhe për pajisjet, të cilat kanë rezultuar brenda normave.</p> <p><i>I gjithë informacioni i kërkuar disponohet në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit: www.aku.gov.al.</i></p>	22.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	--	---	------------	---------	--------

			<ul style="list-style-type: none"><i>A kanë dalë rezultatet paraprake të analizave bakteriologjike apo toksikologjike të ushqimit?</i> <p>Lidhur me pyetjen e trajtuar, sqarojmë se nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është kryer kampionimi i 9 mostrave ushqim gati për konsum dhe lëndë të para të konstatuara në momentin e kontrollit në subjekt, nga të cilat 8 kanë rezultuar brenda normave për treguesit mikrobiologjikë, ndërsa mostra “makarona të gatuar” gati për t’u ngrënë ka rezultuar me Escherichia coli beta-glukuronidase positive dhe Staphylococcus koagulase positive mbi normën e lejuar.</p> <ul style="list-style-type: none"><i>A është vendosur mbyllja e mensës së Akademisë së Sigurisë për shkak të kushteve higjeno-sanitare? Nëse po, cilat janë konkretisht shkeljet apo problematikat e konstatuara nga inspektorët e AKU-së gjatë kontrollit?</i> <p>Ndaj subjektit është marrë masa me ndërprerje aktiviteti referuar raport-provës për produktin makarona të gatuar, e cila ka dalë jokonforme, si dhe referuar raportit epidemiologjik të ardhur nga ISHP, kryer në bashkëpunim me NJVKSH – Tiranë.</p> <p>Nga trupat inspektuese është evidentuar shkelje në lidhje me sistemin e gjurmueshmërisë, ushqim të pasigurt, problem me higjienën, ku janë marrë masa administrative me gjobë. Gjithashtu, ndaj subjektit është kryer masa e ndërprerjes së aktivitetit deri në marrjen e masave nga ana e subjektit për kryerjen e procesit të pastrimit dhe higjienizimit të ambienteve dhe pajisjeve.</p>			
--	--	--	---	--	--	--

			<p>Në vijim, referuar kërkesës së subjektit, është kryer marrje mostrash tamponi ambiental dhe për pajisjet, të cilat kanë rezultuar brenda normave nga analizimi pranë Laboratorit të ISUV.</p> <ul style="list-style-type: none"><i>A është sekuestruar ndonjë sasi ushqimi apo produkte të përdorura nga kompania e kateringut? Çfarë konkretisht është bllokuar?</i> <p>Lidhur me këtë pyetje, informojmë se gjatë inspektimeve të kryera në subjekt është kryer bllokimi i sasisë prej 85.9 kg produkte të gatshme për t'u ngrënë si (pilaf i gatuar, makarona të gatuar, fasule të gatuar, sallam i gatuar, kos i hapur), deri në daljen e përgjigjes së analizave. Gjithashtu, në subjekt është bllokuar (djathë i bardhë lope, kos lope, vezë, sallam) në sasinë 67.3 kg, deri në daljen e përgjigjes së analizave. Nga këto sasi të bllokuara, sasia prej 11.8 kg makarona të gatuar është lënë detyrë që subjekti të marrë masat për asgjësim konform legjislacionit në fuqi, referuar raport-provës jokonforme; pjesa tjetër është zhbllokuar pasi ka rezultuar brenda normave.</p> <ul style="list-style-type: none"><i>A janë konstatuar produkte të skaduara, mungesë dokumentacioni apo shkelje të zinxhirit të ruajtjes së ushqimit?</i> <p>Gjatë procedurës së inspektimit <u> nuk </u> janë konstatuar produkte të skaduara. Pjesa tjetër është sqaruar në pyetjet e sipërcituara.</p> <ul style="list-style-type: none"><i>A ka pasur më parë masa administrative apo gjoba ndaj kompanisë private që furnizon Akademinë e Sigurisë me ushqim?</i>			
--	--	--	---	--	--	--

			<p>Informojmë se ndaj këtij subjekti është vendosur 1 masë administrative “Paralajmërim”, në bazë të konstatimeve të kryera gjatë inspektimit, ndërsa nuk është marrë më parë masë administrative me gjobë ndaj këtij subjekti.</p> <ul style="list-style-type: none"><i>A po hetohet vetëm ushqimi i konsumuar gjatë drekës apo edhe vaktet e tjera të ofruara nga kompania e kateringut?</i> <p>Gjatë kontrolleve të ushtruara pranë subjektit nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit janë kryer verifikime mbi kushtet e higjienës dhe dokumentacionin shoqërues; është kryer procedura e marrjes së produkteve të gatshme për t’u ngrënë dhe lëndëve të para të konstatuara në momentin e kontrollit. Gjithashtu, nga ana e ISHP-së dhe NJVKSH është kryer procedura e marrjes së kampionëve në ruajtje për vaktet e mëngjesit dhe drekës.</p> <ul style="list-style-type: none"><i>Sa inspektime janë kryer deri tani në ambientet e mensës dhe magazinave ushqimore të Akademisë?</i> <p>Lidhur me pyetjen e parashtruar, informojmë se nga viti 2021 deri më 20 maj 2026, janë kryer 13 inspektime brenda ambienteve të Akademisë së Sigurisë, Sauk, Tiranë, dhe në ambientet e kuzhinës së Garnizonit të Forcave të Armatosura, Tiranë.</p> <ul style="list-style-type: none"><i>A ka dyshime paraprake mbi produktin konkret që mund të ketë shkaktuar problemet shëndetësore te studentët?</i>			
--	--	--	--	--	--	--

			<p>Siç është parashtruar më lart, nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është kryer mostrimi i produkteve të gatshme për t'u ngrënë, si dhe i lëndëve të para të konstatuara në momentin e kontrollit. Gjatë këtyre procedurave të kryera nga ana jonë kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të ISHP-së dhe NJVKSH-së. Informojmë se disponohen rezultatet përfundimtare të raport-provave, të trajtuara më sipër.</p> <ul style="list-style-type: none">• <i>Çfarë masash të menjëhershme ka marrë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të garantuar sigurinë ushqimore për studentët e tjerë të Akademisë?</i> <p>Nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është kryer masa e menjëhershme e ndërprerjes së aktivitetit deri në daljen e përgjigjes së analizave për tamponët ambientale dhe për pajisjet, si dhe bllokimi i produkteve të gatshme të konstatuara në momentin e kontrollit, deri në daljen e përgjigjes së analizave.</p> <ul style="list-style-type: none">• <i>A ka bashkëpunim mes AKU-së, ISHP-së dhe Policisë për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe a ka afate konkrete për përfundimin e hetimeve?</i> <p>Ndërmjet Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe ISHP-së është kryer shkëmbimi i informacioneve të disponuara me qëllim marrjen e masave konform kërkesave ligjore në fuqi.</p> <ul style="list-style-type: none">• <i>A ka persona të proceduar administrativisht ose penalisht deri në këtë fazë të hetimit?</i>			
--	--	--	---	--	--	--

			<p>Informojmë se nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi, janë marrë masa administrative përkatëse ndaj subjektit.</p> <ul style="list-style-type: none"><i>A ka dyshime që incidenti lidhet me kontaminim bakterial, ruajtje të papërshtatshme të ushqimit apo neglizhencë higjeno-sanitare?</i> <p>Lidhur me pyetjen e parashtruar, informojmë se referuar Raport-Provës është konstatuar tejkalim i normave për treguesin e higjienës.</p> <ul style="list-style-type: none"><i>Kur pritet të dalë raporti përfundimtar mbi shkaqet e incidentit dhe a do të bëhet publik?</i> <p>Lidhur sa trajtuar, referohen <i>linket</i> ku është bërë publikimi i rastit nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit:</p> <p>https://aku.gov.al/2026/05/07/komunikim-i-autoritetit-kombetar-te-ushqimit-14/</p> <p>https://aku.gov.al/2026/05/09/komunikim-i-autoritetit-kombetar-te-ushqimit-15/</p> <p>https://aku.gov.al/2026/05/14/komunikim-i-autoritetit-kombetar-te-ushqimit-16/</p> <p>https://aku.gov.al/2026/05/19/komunikim-i-autoritetit-kombetar-te-ushqimit-17/</p>			
--	--	--	---	--	--	--

83.	13.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Subjekti ushtron aktivitet kafeneje në Durrës dhe kërkon informacion lidhur me kushtet dhe dokumentacionin që duhet të plotësojë pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për ushtrimin e aktivitetit:</p> <p>Aktiviteti tregtar do të konsistojë kryesisht në: shërbim kafeje dhe pijesh, si dhe shitje të disa ëmbëlsirave/copa keku të gatshme.</p> <p>Produktet ushqimore nuk do të prodhohen në ambientin tim, por do të furnizohen nga një person/subjekt i licensuar dhe i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Do të vlerësoja nëse mund të më informoni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat janë kushtet higjieno-sanitare që duhet të plotësojë ambienti; 2. Çfarë dokumentacioni duhet të disponoj dhe nëse nevojitet regjistrim apo njoftim pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; 3 Çdo procedurë tjetër që duhet të ndjek për të qenë në përputhje me kërkesat ligjore. 	<p>Në përgjigje të kërkesës për informacion, <i>sqarojmë se fillimisht</i>, personi është i detyruar që të kryejë regjistrimin e biznesit të tij (duke u pajisur me numër unik të identifikimit të subjektit — NUIS) pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) referuar llojit të aktivitetit tregtar që kërkon të ushtrojë.</p> <p>Më pas, referuar pikës 19 të VKM-së nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” (i ndryshuar), në Fushën II “Ushqimi dhe Shëndeti”, përcaktohet se subjektet të cilët ushtrojnë aktivitet me pakicë nuk licencohen, pra, nuk janë të detyruar të pajisen me licencë në QKB.</p> <p>Megjithatë, këto subjekte janë të detyruar të njoftojnë drejtorinë rajonale përkatëse të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (në rastin konkret – pranë Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Durrës), duke njoftuar vendin e ushtrimit të aktivitetit (adresën) së bashku me natyrën e tij (përshkrimin e aktivitetit), jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga fillimi i veprimtarisë <u>me pakicë</u>.</p> <p>Në lidhje me vendin dhe natyrën e aktivitetit të subjektit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ushtron inspektimin në vend me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve, sipas legjislacionit në fuqi.</p>	22.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	---	------------	---------	--------

			<p>Është detyrë e çdo OBU i cili përgatit, përpunon, trajton, ruan dhe magazinon produkte ushqimore në mjedise të ushtrimit të aktivitetit me pakicë apo shumicë (në rastin konkret “Bar-Kafe”) që të sigurojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave dhe kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës, rregullat dhe standardet e detyrueshme tekniko-teknologjike në ambientet e tij, si dhe të disponojë dokumentacion të rregullt të produkteve ushqimore, sipas këtij legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none">• Ligji nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar);• Ligji nr.99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;• VKM nr.434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”;• VKM nr.760, datë 16.09.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit, ushqimit për kafshë, përgjatë zinxhirit ushqimor”;• Udhëzimi nr.22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimorë”;• Udhëzimi nr.20, datë 25.11.2010 “Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimentet ushqimore”. <p>Nga institucionet shëndetësore, personeli që do të punojë (punësohet) pranë subjektit në fjalë, duhet të pajiset me librezë shëndetësore, e</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>detyrueshme për çdo person që është pjesë e personelit që punon në fushën e trajtimit apo shitjes së ushqimit, <i>si dhe analiza e ujit për ngarkesën mikrobiologjike.</i></p> <p>Së fundmi, subjekti tregtar duhet të plotësojë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Vendndodhjen, mjedisin, planimetrinë, kushtet dhe gjendjen e subjektit;• Kushtet higjieno-sanitare të ambienteve ku ushtrohet aktiviteti “Bar-Kafe”;• Lëndët e para, uji, produktet ushqimore të gatshme (pije alkoolike dhe joalkoolike), produkte të gatshme pastičerie, etj., duhet të jenë të pajisura me dokumentacionin shoqërues;• Materialet paketuese që subjekti përdor, duhet të jenë në përputhje me kërkesat ligjore;• Subjekti duhet të disponojë Raport-Analizat Laboratorike të lëndëve të para (ujë, kafe, sheqer, etj.) si dhe të produkteve të gatshme;• Hartimi dhe implementimi i planit HACCP, si dhe zbatimin e praktikave të mira të punës e të higjienës (PMH dhe PMP);• Zbatimi e kërkesave të sistemit të gjurmueshmërisë (faturat e blerje/shitjeve me fletë analizat përkatëse);• Zbatimi i planit 3D (plani i brejtësve dhe insekteve).			
--	--	--	---	--	--	--

84.	14.05.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti interesohet nëse është përfitues nga ligji nr.127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake”, me qëllim shuarjen e masës administrative ndaj tij.	Pas verifikimeve të kryera, rezultoi se subjekti nuk ishte përfitues, kjo sipas parashikimeve (kushteve) që normohen në nenin 2, pika 2 e ligjit nr.127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake”.	21.05.2026	e plotë	nuk ka
85.	18.05.2026	Denoncim	Subjekti denoncon duke referuar një problematikë me produktin ‘djathë’, blerë pranë një marketi tek Shkëmbi i Kavajës.	Referuar denoncimit të ardhur , nga ana e trupës inspektuese të Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Durrës (këtu e në vijim, referuar si “ DRAKU Durrës ”), u kryen verifikimet përkatëse në terren lidhur me rastin në fjalë. Konkretisht, trupa inspektuese u paraqit pranë subjektit, ku u konstatua se produkti ‘djathë’ tregtohej në kushte frigoriferike në temperaturë sipas udhëzimit në etiketë. Produkti i tregtuar, ishte i pajisur me faturën përkatëse tatimore dhe brenda datës së skadencës. Nga verifikimi i tij nga ana organo-leptike e trupës inspektuese të DRAKU Durrës, <u>nuk u konstatua</u> prani e krimbit (sikurse referohet në denoncim).	22.05.2026	e plotë	nuk ka

			<p>Temperatura e frigoriferit monitorohej rregullisht dhe nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se subjekti dispononte dokumentacion dezinfektimi nga një kompani e licensuar.</p> <p>Në zbatim të ligjit nr.99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht në nenin 51, pikat 1, 2 dhe 3 të tij, trupa inspektuese procedoi me marrjen e mostrës për produktin 'djathë', duke lënë për detyrë mbajtjen e bllokuar të sasisë së mbetur në ambientin frigoriferik, ku u vendosën gjithashtu shenjat dalluese 'BLOKUAR', deri në daljen e rezultateve të analizave laboratorike.</p> <p><i>Në vijim</i>, sipas Raport-Provës me nr.1/26, datë 20.05.2025 të Laboratorit të DRAKU Durrës, mostra 'djathë i bardhë lope' e analizuar, rezultoi brenda normave të lejuara (konforme).</p> <p>Për këtë arsye, trupa inspektuese u paraqit sërish për inspektim pranë subjektit të lartpërmendur (bazuar në Autorizimin e Inspektimit nr.AKU-DR-2026-000481-1, datë 20.05.2026), nga ku u konstatua se produkti i bllokuar vazhdon të qëndronte i tillë, së bashku me shenjat dalluese të padëmtuara.</p> <p>Në këto kushte, u krye procedura e zhbllokimit të produktit, konform legjislacionit në fuqi.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

86.	19.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Kjo kërkesë lidhet me rastin e bërë publik nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, mbi dyshimin për helmim të disa kursantëve pranë Akademisë së Sigurisë në Sauk, ku pas hetimeve dhe analizave laboratorike u raportua se një mostër makaronash e marrë në kuzhinën e këtij institucioni ka rezultuar jokonforme për tregues të sigurisë ushqimore.</p> <p>Konkretisht, kërkoj të më vihet në dispozicion informacioni mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emrin e firmës/prodhuesit të makaronave që rezultuan jokonforme nga analizat laboratorike; • Markën tregtare të produktit; • Datën e prodhimit dhe skadencës së produktit; • Vendin e prodhimit dhe subjektin përgjegjës për prodhimin/furnizimin; • Nëse produkti është shpërndarë edhe në institucione apo tregje të tjera. 	<p>Nga verifikimet e kryera, rezulton se çështja për të cilën kërkohet informacion është aktualisht objekt i një procedimi penal dhe ndodhet në fazë hetimi pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kështu, informacioni i kërkuar lidhet drejtpërdrejt me veprime hetimore dhe elementë që janë pjesë e një procesi penal.</p> <p>Në këto kushte, vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar në këtë fazë procedurale nuk është e mundur, pasi publikimi i tij mund të ndikojë negativisht në zhvillimin normal të hetimeve, të cenojë efektivitetin e veprimeve procedurale në vijim, si dhe të dëmtojë interesat që legjislacioni në fuqi synon të mbrojë në kuadër të administrimit të drejtësisë dhe garantimit të mbarëvajtjes së procedimit penal.</p> <p>Për sa më sipër, në zbatim të pikës 2, gërma 'b)' e nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), e drejta e informimit kufizohet në rastet kur dhënia e informacionit dëmton ose mund të dëmtojë parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale, si dhe mbarëvajtjen e procedimeve administrative dhe gjyqësore. Në vlerësim të rrethanave konkrete të rastit, rezulton se ekziston një mundësi reale që dhënia e informacionit të kërkuar në këtë moment të shkaktojë dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesit publik të mbrojtur me ligj për zhvillimin e paanshëm dhe efektiv të hetimeve.</p>	02.06.2026	e kufizuar	nuk ka
-----	------------	-------------------------	--	--	------------	------------	--------

87.	19.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Në vijim të përgjigjes zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (<i>nr.ref.75 në këtë tabelë</i>) lidhur me mostrat e produkteve ushqimore të cilat kanë rezultuar jokonforme nga analizat laboratorike, kërkohet të më vihet në dispozicion informacion i plotë dhe i detajuar mbi këto produkte, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emrin e subjektit prodhues/furnizues për secilin produkt të sipërpërmendur; • Markën tregtare (brand-in) e produktit; • Emrin tregtar të saktë të produktit sipas etiketimit; dhe • Fotografinë të etiketës e të produktit të sekuestruar/analizuar. 	<p><i>Në vijim të përgjigjes zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit</i>, lidhur me mostrat të cilat kanë rezultuar <u>jokonforme</u> (jo në përputhje me <i>standardet e sigurisë ushqimore</i>), konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Produkti “<i>Kastravec turshi</i>” me nr.12-Prot.1039 dhe vendi i origjinës: Turqi; • Produkti “<i>Kastravec turshi</i>” me nr.13-Prot.1039 dhe vendi i origjinës: Turqi; • Produkti “<i>Sallatë e përzier e marinuar</i>” me nr.09-Prot.1036 dhe vendi i origjinës: Maqedoni e Veriut; dhe • Produkti “<i>Perime turshi</i>” me nr.220 Prot.-n°123 dhe vendi i origjinës: Elbasan; informojmë se: <p><i>Lidhur me emrin e subjektit prodhues/furnizues për secilin produkt</i>, fillimisht bëjmë me dije se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në zbatim të kompetencave të tij ligjore për kontrollin zyrtar të ushqimit, ka ndjekur të gjitha procedurat përkatëse inspektuese dhe administrative mbi rastet e evidentuara. Kështu, për mostrat e lartpërmendura, pas administrimit të rezultateve laboratorike dhe dokumentacionit inspektues ndaj subjekteve ku janë marrë mostrat dhe/ose subjektet përgjegjëse, janë vendosur masat administrative 'Gjobë'.</p> <p>Në vijim, subjektet ndaj të cilëve janë vendosur këto masa administrative, janë duke ndjekur hapat ligjorë për ankimin e masave të marra ndaj tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe me parimet e procesit të rregullt administrativ.</p>	02.06.2026	e kufizuar	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	---	------------	------------	--------

Kodi i Procedurave Administrative parashikon se veprimtaria administrative zhvillohet duke respektuar procesin e rregullt ligjor, ligjshmerinë, transparencën, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale. Për këtë arsye, publikimi në këtë fazë i emrave të subjekteve, markave tregtare, emrave tregtarë të produkteve dhe fotografive të etiketave/produkteve, për sa kohë masat administrative janë objekt ankimi dhe procesi administrativ nuk ka marrë ende një përfundim të pakontestueshëm, do të krijonte rrezik për cenimin e procesit të rregullt administrativ, të së drejtës së ankimit, të interesave të ligjshme tregtare të subjekteve dhe të parimit të proporcionalitetit.

Lidhur me markën tregtare (brand-in) e produktit dhe emrin tregtar sipas etiketimit:

- Kornison Turşusu, Gurken Würzig Eingelegt (kastravec turshi) 700g;
- Kornison Turşusu, Gurken Würzig Eingelegt (kastravec turshi) 700g;
- Sallate mikse (marinade) Pema 680g;
- Perime turshi.

Lidhur me fotografitë e etiketës dhe të produktit të sekuestruar/analizuar:

<https://kommodo.ai/i/weVf44RmKzAnkQGDxjWU>

<https://kommodo.ai/i/kTEXOrUINEjVtfhn8tRP>

<https://kommodo.ai/i/jOU72agRvzLgE2ZjLNgs>

<https://kommodo.ai/i/vuWKYLpE9kmN2bqf7rof>

88.	21.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Në mbështetje të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), kërkoj vënien në dispozicion të informacionit dhe dokumenteve si më poshtë:</p> <p>1. Numri i rasteve të konstatuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, gjatë viteve 2023, 2024, 2025 dhe tre mujori 2026, që lidhen me shkelje të sigurisë ushqimore;</p> <p>2. Lista e subjekteve të gjobitura ose të bllokuara për shkelje të standardeve të sigurisë ushqimore gjatë kësaj periudhe;</p> <p>3. Të dhëna mbi produktet ushqimore të bllokuara ose të tërhequra nga tregu gjatë viteve 2023-2025 dhe arsyet përkatëse;</p> <p>4. Numri i inspektimeve të kryera nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit sipas qarqeve dhe kategorive të bizneseve;</p> <p>5. Informacion mbi rastet e helmimeve ushqimore të referuara pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe masat e marra;</p> <p>6. Procedurat standarde që ndjek Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për kontrollin e sigurisë ushqimore në institucione arsimore, menza, restorante dhe supermarkete;</p>	<p>Në përgjigje të pyetjes së parë, nga verifikimet e kryera, rezulton se për Operatorët e Biznesit Ushqimor (OBU), të cilët nuk kanë plotësuar standardet ushqimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, janë vendosur masat administrative përkatëse, sipas viteve:</p> <p>Për vitin 2023:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Paralajmërime në total 4,817 (katër mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë); – Gjoba në nr.504 (pesëqind e katër); – Ndërprerje aktiviteti në total 39 (tridhjetë e nëntë) raste; – Bllokim produkti në total 338 (treqind e tridhjetë e tetë) raste; – Asgjësime produkti në total 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) raste. <p>Për vitin 2024:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Paralajmërime në total 3,510 (tre mijë e pesëqind e dhjetë); – Gjoba në nr.294 (dyqind e nëntëdhjetë e katër); – Ndërprerje aktiviteti në total 37 (tridhjetë e shtatë) raste; – Bllokim produkti në total 248 (dyqind e dyzet e tetë) raste; – Asgjësime produkti në total 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër) raste. <p>Për vitin 2025:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Paralajmërime në total 1,261 (një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një); – Gjoba në nr.433 (katërqind e tridhjetë e tre); – Ndërprerje aktiviteti në total 23 (njëzet e tre) raste; 	22.05.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	---	--	------------	---------	--------

			<p>7. Informacion lidhur me rastin e fundit të raportuar publikisht që përfshiu studentë të Akademisë së Shkencave, përfshirë masat e marra nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe rezultatet e analizave, nëse ka.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Bllokim produkti në total 475 (<i>katërqind e shtatëdhjetë e pesë</i>) raste; – Asgjësime produkti në total 257 (<i>dyqind e pesëdhjetë e shtatë</i>) raste. <p>Për periudhën 3-mujore (Janar-Mars) 2026:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Paralajmërimet në total 84 (<i>tetëdhjetë e katër</i>); – Gjoha në nr.81 (<i>tetëdhjetë e një</i>); – Ndërprerje aktiviteti në total 9 (<i>nëntë</i>) raste; – Bllokim produkti në total 83 (<i>tetëdhjetë e tre</i>) raste; – Asgjësime produkti në total 65 (<i>gjashtëdhjetë e pesë</i>) raste. <p><i>Në përgjigje të pyetjes së dytë</i>, nga verifikimet e kryera, rezulton se numri i gjobave së bashku me vlerën e tyre totale, si dhe rastet e ndërprerjeve të aktivitetit ndaj Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU) për shkelje të standardeve të sigurisë ushqimore gjatë kësaj periudhe, është sa më poshtë pasqyrohet.</p> <p>Për vitin 2023:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Gjoha në nr.504 me vlerë totale prej ALL 80,300,000 (<i>tetëdhjetë milion e treqind mijë lekë</i>); – Ndërprerje aktiviteti në total 39 (<i>tridhjetë e nëntë</i>) raste. <p>Për vitin 2024:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Gjoha në nr.294 (<i>dyqind e nëntëdhjetë e katër</i>) me vlerë totale prej ALL 44,670,000 (<i>dyzet e katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë lekë</i>); – Ndërprerje aktiviteti në total 37 (<i>tridhjetë e shtatë</i>) raste. 		
--	--	--	---	--	--	--

			<p>Për vitin 2025:</p> <ul style="list-style-type: none">– Gjoba në nr.433 (<i>katërqind e tridhjetë e tre</i>) me vlerë totale prej ALL 52,940,000 (<i>pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e dyzet mijë lekë</i>);– Ndërprerje aktiviteti në total 23 (<i>njëzet e tre</i>) raste. <p>Për periudhën 3-mujore (Janar-Mars) 2026:</p> <ul style="list-style-type: none">– Gjoba në nr.81 (<i>tetëdhjetë e një</i>) me vlerë totale prej ALL 13,410,000 (<i>trembëdhjetë milion e katërqind e dhjetë mijë lekë</i>);– Ndërprerje aktiviteti në total 9 (<i>nëntë</i>) raste. <p><i>Në përgjigje të pyetjes së tretë</i>, në lidhje me produktet ushqimore të bllokuara ose të tërhequra nga tregu për periudhën e kërkuar, së bashku me arsyet përkatëse, rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none">– Për vitin 2023 janë bllokuar në total 338 (<i>treqind e tridhjetë e tetë</i>) produkte, me sasi 429 ton; 10,694 litra; 7,968 kokrra vezë dhe 72,600 copë;– Për vitin 2024 janë bllokuar në total 248 (<i>dyqind e dyzet e tetë</i>) produkte, me sasi 396.2 ton; 216,394.3 litra; 146 kokrra vezë dhe 255 copë;– Për vitin 2025 janë bllokuar në total 475 (<i>katërqind e shtatëdhjetë e pesë</i>) produkte, me sasi 1,164.64 ton; 27,317.49 litra; 1,611,402 kokrra vezë dhe 37 copë. <p><i>Ndër arsyet kryesore për marrjen e masave administrative të sipërcituara</i>, përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none">– tregtimin e ushqimit të pasigurt për konsum;– mungesën e gjurmueshmërisë;			
--	--	--	---	--	--	--

- mungesën e planit HACCP/mosimplementimi i tij;
- produkte pa etiketë në gjuhën shqipe;
- produkte me afat përdorimi të kaluar;
- mungesë e kushteve higjieno-sanitare;
- analiza jokonforme;
- mosbashkëpunim për kryerje inspektimi;
- mosrealizim i detyrave të lëna nga inspektimi paraardhës etj.

Në përgjigje të pyetjes së katërt, rezulton se Sektori i Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU), ka kryer në total:

Periudha	2023	2024	2025	Janar - Mars 2026
Drejtoria Rajonale				Nr. i inspektimeve të kryera
Tiranë	7,521	7,013	5,336	418
Durrës	3,455	3,298	2,429	103
Berat	1,806	1,128	887	39
Shkodër	2,425	2,057	1,613	37
Vlorë	2,236	2,562	1,480	37
Fier	2,492	2,850	1,822	91
Dibër	1,694	968	553	12
Elbasan	1,409	2,554	1,749	72
Korçë	1,622	1,932	1,252	60
Lezhë	890	1,492	888	12
Gjirokastrë	2,059	1,531	1,078	49
Kukës	785	771	455	9
Total	28,394	28,156	19,542	939

Nga verifikimet e kryera, rezulton se nga inspektimet e kryera nga Sektori i Mbrojtjes së Bimëve dhe Inpoteve Bujqësore, janë kryer:

Periudha	2023	2024	2025	Janar - Mars 2026
Drejtoria Rajonale				Nr. i inspektimeve të kryera
Tiranë	517	517	341	10
Durrës	214	215	157	7
Berat	319	312	185	3
Shkodër	430	445	275	2
Vlorë	169	183	128	1
Fier	961	699	447	20
Dibër	134	130	72	0
Elbasan	353	383	206	5
Korçë	321	293	192	0
Lezhë	593	453	271	4
Gjirokastër	140	168	89	3
Kukës	89	93	57	0
Total	4,240	3,891	2,420	55

Në përgjigje të pyetjes së pestë, për sa i përket rasteve të helmimeve ushqimore të referuara pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, informojmë se përgjatë periudhës Janar – 20 Maj 2026, rezulton vetëm **1 (një) rast** i referuar si helmim, konfirmuar nga raporti përfundimtar epidemiologjik.

			<p>Referuar trajtimit të këtij rasti, informojmë se bazuar në Raport-Provën për produktin ‘<i>makarona të gatuar</i>’ e cila ka rezultuar <u>jokonforme</u> për ‘<i>Escherichia coli</i> beta-glukuronidase positive’ dhe ‘<i>Staphylococcus koagulase positive</i>’ mbi normën e lejuar, si dhe Raportit Përfundimtar Epidemiologjik të ardhur nga ISHP në bashkëpunim me NJVKSH Tiranë, nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është proceduar me ndërprerjen e aktivitetit deri në plotësimin e kushteve në zbatim të legjislacionit në fuqi për ushqimin.</p> <p>Gjithashtu, informojmë se ndaj subjektit është marrë masë administrative ‘<i>Gjobë</i>’ për ushqim të pasigurt si dhe kushte higjieno-sanitare, masë administrative ‘<i>Paralajmërim</i>’ dhe lënie afati për korrigjimin e detyrave të lëna, <i>si dhe</i> njoftimi pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.</p> <p><i>Në vijim të ndjekjes së rastit</i>, si dhe referuar njoftimit të vetë subjektit për realizimin e detyrave, nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është kryer marrja e mostrave tampone ambientale si dhe për pajisjet në ambientet e kuzhinave, të cilat, nga analizimi i tyre pranë Labororit të ISUV, kanë rezultuar <u>brenda normales</u>.</p> <p>Në kuadër të sa më sipër, referuar Raport-Provave, është proceduar me zhbllokimin e aktivitetit të subjektit.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

			<p><i>Në përgjigje të pyetjes së gjashtë</i>, sqarojmë se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ushtron veprimtarinë e tij në zbatim të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “<i>Për Ushqimin</i>” (i ndryshuar); ligjit nr.99/2024 “<i>Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë</i>”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Në zbatim të legjislacionit në fuqi, me marrjen e njoftimit nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, autorizohet kryerja e verifikimeve në terren nga kryeinspektori i qarkut. Kështu, nga trupa inspektuese kryhen verifikimet përkatëse në subjekt mbi gjendjen fizike (kushtet higjieno-sanitare) dhe dokumentacionin përkatës në zbatim të përcaktimeve ligjore.</p> <p>Për qëllim të inspektimit, kryhet procedura e marrjes së mostrave dhe me daljen e rezultatit (përgjigjes) së analizave të mostrave, kryhen procedurat përkatëse. Në rastet kur kemi mostra <u>jokonforme</u>, ndaj subjektit merret masa e ndërprerjes së aktivitetit, masa administrative me gjobë dhe lënie detyrash. Gjithashtu, informojmë se nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryhet shkëmbim informacioni me institucionet e tjera në mënyrë të ezaurimit të plotë të të gjithë hallkave.</p> <p><i>Në përgjigje të pyetjes së fundit</i>, referuar denoncimit të ardhur si rast dyshimi për helmim të disa kursantëve pranë Akademisë së Sigurisë Sauk, Tiranë, janë kryer verifikimet përkatëse nga Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë, ku për qëllim të</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>inspektimit është kryer procedura e marrjes së mostrave në adresat e subjektit, më konkretisht, produkte të gatshme dhe lëndë të para të konstatuara në momentin e kontrollit, të cilat janë dërguar për analizim pranë laboratorit të ISUV, për tregues mikrobiologjikë.</p> <p>Nga këto kampione, vetëm 1 (një) ka rezultuar jokonform, konkretisht produkti ‘<i>makarona të gatuar</i>’ ku referuar kësaj Raport-Prove, si dhe Raportit Përfundimtar Epidemiologjik të ardhur nga ISHP në bashkëpunim me NJVKSH Tiranë, u morën masa me ndërprerje aktiviteti, masë administrative ‘<i>Gjobë</i>’ për ushqim të pasigurt dhe kushte higjieno-sanitare, masë administrative ‘<i>Paralajmërim</i>’ dhe lënie detyre për kryerjen e procedurës së pastrimit e higjienizimit të ambientit e pajisjeve.</p> <p>Nga ana e subjektit janë kryer detyrat e lëna dhe është njoftuar Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Referuar këtij njoftimi, nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, u morën mostra tamponi ambiental dhe për pajisjet, ku nga analizimi i tyre pranë laboratorit të ISUV, rezultoi se ishin <u>konform</u> normave të lejuara për treguesit mikrobiologjikë.</p> <p>Referuar këtyre Raport-Provave është proceduar me zhblokimin e aktivitetit pranë dy adresave të subjektit.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

89.	27.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Subjekti i interesuar është regjistruar si person fizik (PF) pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, lidhur me shitjen e sapunëve organikë.</p> <p>Pavarësisht se ende nuk ka filluar me shitjen e produkteve dhe ushtrimin e aktivitetit tregtar, subjekti kërkon informacion lidhur me shitjen e turshive dhe reçelrave të prodhuara vetë (shitje me pakicë), se çfarë procedure dhe dokumentacioni nevojitet për tregtimin e këtyre produkteve.</p>	<p>Subjektet që kryejnë veprimtari me pakicë nuk licencohen, por këto subjekte janë të detyruara që të kryejnë regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe të njoftojnë Drejtorinë Rajonale përkatëse të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për vendin e kryerjes së aktivitetit dhe natyrën e tij, jo më vonë se 30 (<i>tridhjetë</i>) ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë.</p> <p>Referuar VKM-së nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” (i ndryshuar), përcaktohet shprehimisht se: “Subjektet që kryejnë veprimtari me pakicë lidhur me nënkategoritë A dhe B e që kupton subjektet e regjistruara si pagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël nuk licencohen. Këto subjekte janë të detyruara të njoftojnë autoritetet e përmendura si institucion tjetër lidhur me nënkategoritë A dhe B për vendin e kryerjes së aktivitetit dhe natyrën e tij jo më vonë se 30 (<i>tridhjetë</i>) ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë”, për licencat e Grupit të Tretë (që i përkasin Autoritetit Kombëtar të Ushqimit); Fusha II; Ushqimi dhe Shëndeti; Kategoria II.I; Prodhimi dhe/ose Tregtimi i Ushqimeve.</p> <p>Lidhur me kriteret që duhen plotësuar në ambientin e prodhimit (për aktivitetet prodhuese) — në rastin konkret, prodhim, tregtim të turshive dhe reçelit, sqarojmë se është detyrë e çdo Operatori të Biznesit Ushqimor (OBU) që përgatit, përpunon, prodhon, ruan dhe shpërndan produkte ushqimore në mjedise të</p>	03.06.2026	e plotë	nuk ka
-----	------------	-------------------------	--	---	------------	---------	--------

			<p>ushtirimit të aktivitetit me pakicë apo shumicë, të sigurojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave dhe kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës, rregullat dhe standardet e detyrueshme tekniko-teknologjike, në ambientet e tij, si dhe dokumentacion të rregullt të produkteve ushqimore sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none">• Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar);• Ligjin nr.99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;• VKM-në nr.434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”; dhe• Udhëzimin nr.22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”. <p>Me qëllim ushtirimit e aktivitetit prodhues dhe/ose tregtues të ushqimeve, subjekti duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">• Vendndodhjen, kushtet dhe gjendjen e stabilimentit, planimetrinë e prodhimit, zyrat, mjedisin, mjetet e transportit (nëse bën transport);• Kushtet higjiëno-sanitare të prodhimit/përpunimit, tregimit etj.;• Librezat shëndetësore (të detyrueshme për çdo person i cili është pjesë e personelit që punon në fushën e trajtimit apo shitjes së ushqimit);• Lëndët e para, shtesat teknologjike (dokumentacioni shoqërues), sipas legjislacionit në fuqi;			
--	--	--	---	--	--	--

				<ul style="list-style-type: none"> • Fletë-analizën e ujit për ngarkesën mikrobiologjike; • Mënyrën e paketimit dhe materialet paketuuese; • Etiketimin dhe dokumentet shoqëruese të lëndëve të para dhe produktit përfundimtar; • Proceset teknologjike që zbatohen në prodhim (karta teknologjike); • Drejtuesi teknik (aktivitet prodhues) ose personi përgjegjës për sigurinë ushqimore (shitje/shpërndarje); • Plani i Vetëkontrollit HACCP, bazuar në nenin 26 të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar); • Sistemi i gjurmueshmërisë; dhe • Plani 3D. 			
90.	28.05.2026	Kërkesë për informacion	<p>Subjekti i interesuar kërkon informacion në lidhje me certifikatën shëndetësore veterinarë (Health Certificate) që nevojitet për të eksportuar ushqim për kafshë shtëpiake (pet food, treats dhe snacks) në vendin tonë.</p> <p><i>Shënim: Kërkesa për informacion është dërguar në anglisht.</i></p>	<p>Autoriteti kompetent përgjegjës për kërkesat veterinarë dhe kushtet e importit të ushqimeve për kafshët shtëpiake është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), nëpërmjet strukturave të saj veterinarë.</p> <p>Lidhur me informacionin e kërkuar nga subjekti mbi certifikatën shëndetësore veterinarë si dhe kushtet që duhet të përmbushen për importin e ushqimit për kafshët shtëpiake në Republikën e Shqipërisë, u referua për t’iu drejtuar MBZHR në adresën elektronike info@bujqesia.gov.al dhe/ose të vizitoni faqen zyrtare të tyre: www.bujqesia.gov.al.</p> <p><i>Shënim: Kthim përgjigjja e kërkesës për informacion është dërguar në anglisht tek subjekti i interesuar.</i></p>	03.06.2026	e plotë	nuk ka